



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dërgimi / Prilazje / Post / Received / Delivery	09.08	2023	3	viti god year
Organi / Shista / Organ / Jedinec / Org / Unit	KPM SHCK	560/1	2023	1.1.8



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.884/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.884/2023 të datës 26.06.2023 e parashtruar nga Komuna e Vushtrrisë, kundër organit të punësimit Komunës së Vushtrrisë, në çështjen juridike “Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 09.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër Anr.884/2023 e datës 26.06.2023 e parashtruar nga ankesuesja

II. Mbetet në fuqi Njoftimi nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë me numër 25296/23 i datës 09.06.2023.

A r s y e t i m

Ankuesja ka aplikuar në konkursin e shpallur me numër referencës RN00011261 nga Komuna e Vushtrrisë, i publikuar sipas njoftimit të datës 22.03.2023 dhe afati për aplikim nga data 12.04.2023 deri me datë 26.04.2023, në vendin e lirë të punës Specialistë i Psikologjisë në pozitën “Zyrtar për Çështje Psikologjike”. Me datë 04.05.2023 me numër protokollit 19260/23 është shpallë Lista e kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta në të cilën listë ka qenë vetëm kandidatja Arlinda Kasumi, ku afati për të ushtruar ankesë për kandidatët e refuzuar ka qenë prej tre (3) ditësh nga dita e njoftimit individual. Ndërsa me datë 08.05.2023 është shpallur lista përfundimtare ku përfshihen edhe tre (3) kandidatë tjerë të cilët gjithashtu i plotësojnë kriteret. Në të cilën procedurë ankuesja ka qenë e përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit dhe pas intervistës me gojë,

ankuesja është njoftuar me datë 01.06.2023 lidhur me pikët e arritura, gjithsejtë 76.8 pikë, duke u renditur e dyta në listën përfundimtare dhe duke e njoftuar për të drejtën e ankesës prej 3 ditësh.

Ankuesja ka parashtruar ankesë me datë 02.06.2022 tek Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim dhe karrierë në shërbimin civil, me pretendimet ankimore se gjatë verifikimit paraprak Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ka shkelur afatet ligjore në shpalljen e listës përfundimtare të verifikimit paraprak, pas afatit për ankesa.

Me datë 07.06.2023 Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim dhe karrierë ka nxjerrë vendimin me numër protokollit 24966/22 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses të datës 02.06.2023, në lidhje me kontestimin e rezultateve të vlerësimit në procedurën e rekrutimit për Grupin Specialistë i Psikologjisë, pozita e punës ‘Zyrtar për Çështje Psikologjike, me referencë RN00011261, RPC0004897.

Ankuesja me datë 26.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4908/2023 të regjistruar me numër A.nr.884/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se gjatë verifikimit paraprak Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ka shkelur afatet ligjore në shpalljen e listës përfundimtare të verifikimit paraprak, pas afatit për ankesa dhe se kandidatët që janë përfshirë në listën përfundimtare nuk i plotësojnë kriteret lidhur me përvojë e punës një vjeçare sipas konkursit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.07.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vushtrisë, ndërsa Këshilli më datë 10.07.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga e njëjta me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:4908/2023 të datës 26.06.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga A.K. për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 26.06.2023; Njoftim për verifikimin paraprak nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrisë me numër 19260/23 i datës 04.05.2023; Njoftim për testim me shkrim i datës 19.05.2023; E-mail i datës 19.05.2023; E-mail i datës 19.05.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 04.07.2023; E-mail nga C.Z. për B.D. 04.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 12.07.2023; E-mail nga B.D. për C.Z. i datës 10.07.2023; Konkurs për pranim me emrin e Grupit Specialistë të Psikologjisë për pozitën “Zyrtar për çështje Psikologjike” i datës 22.03.2023; Kërkesë e datës 13.01.2023; Vendim për formimin e komisionit për pranim me numër protokollit 553/23 i datës 08.05.2023; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i J.S. me numër protokollit 1168/19 i datës 09.10.2019; Akt Emërim i B.V. me numër protokollit 92/17 i datës 01.02.2017; Akt Emërim i E.M. me numër protokollit 700 i datës 25.01.2011; Akt Emërim i M.J. me numër AE.nr.20-035/01-0017004/22 i datës 01.04.2022; Marrëveshje nga Komuna e Vushtrisë për R.K. me numër protokollit 02/23 i datës 05.01.2023; Akt Emërim i L.H. me numër protokollit 322/14 i datës 10.03.2014; E-mail nga L.H. për J.S. i datës 22.05.2023; E-mail nga J.S. për A.K. etj. i datës 19.05.2023; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ; Njoftim për verifikimin përfundimtar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me numër protokollit nga 19747/23 i datës 08.05.2023; Njoftim për verifikimin paraprak nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me numër protokollit 19260/23 i datës 04.05.2023;

Vendim nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me numër protokollit 19242/23 i datës 04.05.2023; Vendim nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me numër protokollit 19720/23 i datës 08.05.2023; Vendim nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me numër protokollit 19244/23 i datës 04.05.2023; Vendim nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me numër protokollit 19719/23 i datës 08.05.2023; Vendim nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me numër protokollit 19241/23 i datës 04.05.2023; Vendim nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me numër protokollit 19722/23 i datës 08.05.2023; E-mail nga J.S. për A.K. etj. i datës 11.05.2023; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ; E-mail nga J.S. për F.Z. etj. i datës 16.05.2023; E-mail nga J.S. për F.Z. etj. i datës 17.05.2023; Shkresë e Komisionit të vlerësimit për pranim; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 02.06.2023; Ankesë e ankueses drejtuar Komisionit për pranim; Letërnjoftim i A.K.; Vendim i Komisionit për pranim me numër protokollit 24966/22 i datës 07.06.2023; Vendim i Komisionit për pranim me numër protokollit 25283/23 i datës 09.06.2023; Ankesë e Z.T.F. drejtuar Komisionit për pranim i datës 01.06.2023; E-mail nga simbni@rks-gov.net për Z.T. i datës 29.05.2023; Vendim i Komisionit për pranim me numër protokollit 25281/23 i datës 09.06.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve me numër protokollit 23832/23 i datës 31.05.2023; Njoftim për rezultatet e vlerësimit me numër protokollit 23859/23 i datës 01.06.2023; Njoftim për rezultatet përfundimtare të vlerësimit me numër protokollit 25296/23 i datës 09.06.2023; Testi i datës 23.05.2023; Testi i datës 16.05.2023; Aplikacioni i E.Sh. i datës 15.04.2023; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" i E.H.SH. me numër Nr.3097 i datës 06.02.2014; Diplomë nga Kolegji AAB i E.SH. me numër Nr.3766/22 i datës 21.10.2022; Certifikatë nga MASHTI për E.SH. me numër Nr.14814/008 e muajit shtator 2021; Certifikatë licencimi për E.SH. me numër Nr. i Licences 688/21 i datës 18.03.2021; Vërtetim nga Njësia e Personelit në Komunën e Vushtrrisë për E.SH. me numër protokollit 42632/20 i datës 24.09.2020; Letër rekomandim nga Njësia e Personelit në Komunën e Vushtrrisë për E.SH. me numër protokollit 11677/21 i datës 16.03.2021; Kontratë pune për punë dhe detyra specifike nga Komuna e Vushtrrisë për E.SH. me numër protokollit 1065/21 i datës 31.08.2021; Certifikatë nga MASHTI për E.SH. me numër Nr.0065/18 e vitit 2018; Certifikatë nga Diakonie Kosova për E.SH. i datës 21.11.2017; Rekomandim nga Drejtoresha e shkolles fillore "Mustafë Venhari" Vushtrri për E.SH.; Certifikatë nga The cambridge school për E.SH. i datës 19.03.2014; Certifikatë nga The cambridge school për E.SH. i datës 29.07.2013; Certifikatë nga The cambridge school për E.SH. i datës 14.06.2013; Certifikatë nga qendra rinore Hareja për E.H. i datës 20.10.2004; Certifikatë nga The cambridge school për E.SH. i datës 30.07.2014; Pëlqim nga Drejtoria për Arsim në komunën e Vushtrrisë i datës 19.01.2018; Letërnjoftim i E.SH.; Certifikatë mbi dënimet penale e E.SH. i datës 12.04.2023; Ankesë e E.SH. drejtuar Njesisë për menaxhimin e burimeve njerëzore i datës 05.05.2023; Pasqyra e llogarisë nga trusti e E.SH. i datës 01.08.2002-02.05.2023; Vërtetim nga shpk. Te duli furniture për E.SH.; Kontratë pune për kohë të caktuar/ të pacaktuar nga kopshti Dielloni Vushtrri për E.SH. i datës 01.06.2014; Kontratë pune për kohë të caktuar/ të pacaktuar nga D.P.Z. Te duli për E.SH. i datës 01.03.2019; Kontratë pune për punë dhe detyra specifike nga komuna e Vushtrrisë për E.SH. me numër protokollit 1065/21 i datës 31.08.2021; Aplikacioni i A.K. i datës 26.04.2023; Diplomë e shkollës së mesme e A.K. me numër protokollit 314 i datës 26.05.2017; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" i A.K. me numër Nr.7210 i datës 19.10.2020; Certifikatë e notave nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" i A.K. me numër Ref.nr.3619/04 i datës 29.10.2021; Certifikatë nga PEE për A.K.; Certifikatë nga PEE për A.K.; Certifikatë nga qendra e prindërve me fëmij me pengesa në zhvillim për A.K. i datës 24.06.2022; Certifikatë nga shoqata e psikologëve të Kosovës "Intelekti" për A.K. i datës 20.03.2022; Certifikatë nga shoqata e psikologëve të Kosovës "Intelekti" për A.K. i datës 26.03.2022; Certifikatë nga shoqata e psikologëve të Kosovës "Intelekti" për A.K. i datës 30.01.2022; Certifikatë nga MFE për A.K. i muajit Qershor 2022; Certifikatë nga MASHTI për A.K. i datës 28.04.2021; Certifikatë nga Peace Corps për A.K. e datës 08.03.2017; Certifikatë nga Unicef për A.K. i datës

28.12.2021; Kontratë pune për punë dhe detyra të caktuara nga Institucioni parashkollor OJQ "Shkronjat" i datës 09.08.2022; Certifikatë e regjistrimit nga ARBK për A.K. i datës 01.11.2022; Letër referencë nga Institucioni parashkollor OJQ "Shkronjat" për A.K. i datës 07.03.2023; Vërtetim nga shkolla e mesme e ulët-2 për A.K. i datës 28.06.2021; Letër referencë nga SHFMU "A.Z.Çajupi" për A.K. i datës 16.06.2021; Pasqyra e llogarisë nga trusti për A.K. i datës 24.04.2022-24.04.2023; Certifikatë mbi dënimet penale për A.K. i datës 24.04.2023; Aplikacioni i L.B. i datës 20.04.2023; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" i L.B. me numër Nr.5052 i datës 20.12.2016; Certifikatë nga shoqata e psikologëve të Kosovës "Intelekti" për L.B. i datës 26.03.2022; Certifikatë nga shoqata e psikologëve të Kosovës "Intelekti" për L.B. i datës 27.03.2022; Certifikatë nga Caritas për L.B.; Certifikatë nga Caritas i datës 14.12.2022; Kontratë për praktikë nga qendra mediko psikoterapike Labyrinth për L.B. i datës 01.03.2016; Deklarat detyrimi për praktikantin L.B.; Vërtetim nga qendra mediko psikoterapike Labyrinth për L.B. i datës 20.12.2022; Marrëveshje për shërbime të veçanta nga MMPH-AKK për L.B. me numër protokollit 01-1665/19 i datës 23.07.2019; Kontratë me marrëveshje të veçantë të shërbimit nga MMPH-AMMK i datës 05.12.2018; Kontratë pune për kohë të caktuar nga Kopshti i Fëmijëve Hareja SHPK. për L.B. i datës 02.03.2019; Kontratë pune për punë dhe detyra specifike nga Komuna e Vushtrisë për L.B. me numër protokollit 1067/21 i datës 31.08.2021; Vërtetim nga Ambulanca e psikologjisë klinike biznes individual B.I. për L.B. i datës 19.04.2023; Letërnjoftim i L.B.; Letër rekomandim nga MPB-DRPR për L.B. me numër protokollit 1163-1 i datës 30.05.2017; Certifikatë mbi dënimet penale për L.B. i datës 03.04.2023; Ankesë drejtuar Njesisë për menaxhimin e burimeve njerëzore e L.B.; Pasyra e llogarisë nga trusti e L.B. i datës 21.01.2010-02.05.2023; Aplikacioni i Z.T.F. i datës 25.04.2023; Diplomë për kryerjen e shkolles së mesme të lart Gjimnazit e Z.T. me numër protokollit 383 i datës 11.06.2007; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" i Z.T. me numër Nr.2459 i datës 06.03.2013; Certifikatë nga QKKP për Z.T. i datës 23.10.2016; Certifikatë nga QKKP për Z.T. i datës 04.12.2016; Certifikatë nga QKKP për Z.T. i datës 30.04.2017; Certifikatë nga Diakonie për Z.T. i datës 23.11.2017; Certifikatë nga Diakonie për Z.T. i datës 06.12.2017; Certifikatë nga EU për Z.T. i datës 15.02.2018; Certifikatë licencimi me numër Nr. i licencës 264/18 R i Z.T. i datës 23.03.2018; Certifikatë nga organizata joqeveritare autizmi flet për Z.T. i datës 15.09.2018; Certifikatë nga PEN për Z.T.; Certifikatë licencimi me numër Nr. i licencës 264 për Z.T. i datës 02.06.2021; Certifikatë nga Diakonie për Z.T. i datës 15.12.2021; Certifikatë nga WAAP për Z.T. i datës 12.07.2017; Certifikatë nga Diakonie për Z.T. i datës 22.12.2015; Certifikatë nga QKPP për Z.T. i datës 05.03.2017; Vërtetim nga Diakonie për Z.T. i datës 12.10.2015; Certifikatë nga shoqata autizmi për Z.T. e vitit 2013; Certifikatë nga Diakonie për Z.T. i datës 17.11.2013; Certifikatë nga Diakonie për Z.T. i datës 14.12.2013; Certifikatë nga Diakonie për Z.T. i datës 26.06.2023; Certifikatë nga Diakonie për Z.T. i datës 23.02.2014; Certifikatë licencimi me numër Nr. i licences 264/14 i datës 30.06.2014; Certifikatë nga Diakonie për Z.T. i datës 21.06.2014; Certifikatë nga Diakonie për Z.T. i datës 10.09.2014; Certifikatë nga EU për Z.T. i datës 13.12.2013; Certifikatë nga Diakonie për Z.T. i datës 06.12.2014; Certifikatë nga Diakonie për Z.T. i datës 11.07.2015; Vërtetim nga IPP "Gëzimi Ynë" për Z.T. i datës 22.01.2014; Vërtetim nga QMGF për Z.T. i datës 19.03.2021; Kartë identifikimi nga QMGF për Z.T. me numër 02; Referencë nga QMGF për Z.T. i datës 08.05.2018; Letërnjoftim i Z.T.F.; Certifikatë mbi dënimet penale e Z.T.F. i datës 30.03.2023; CV-ja e Z.T.F.; Ankesë e Z.T.F. drejtuar Njesisë për menaxhimin e burimeve njerëzore e datës 05.05.2023; Pasqyra e llogarisë së trustit e Z.T. e datës 05.11.2013-30.04.2023; Pasqyra e llogarisë së trustit e Z.T. e datës 01.01.2022-31.12.2022; Vërtetim nga QMGF për Z.T. i datës 19.03.2021; Pliko me numër R2897283 i datës 10.07.2023; E-mail nga B.D. për C.Z. i datës 08.08.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, ka konstatuar ankesa ankueses *], është e pa bazuar, sepse:*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka parashtruar ankesë me pretendimet ankimore se gjatë verifikimit paraprak Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ka shkelur afatet ligjore në shpalljen e listës përfundimtare të verifikimit paraprak, pas afatit për ankesa dhe se kandidatët që janë përfshirë në listën përfundimtare nuk i plotësojnë kriteret lidhur me përvojë e punës një vjeçare sipas konkursit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, sipas shkresave të lëndës, ka konstatuar se Komuna e Vushtrisë, sipas njoftimit të datës 22.03.2023 ka publikuar konkursin për grupin Specialist të Psikologjisë për pozitën "Zyrtar për Çështje Psikologjike", me numër reference RN00011261 për afatin për aplikim nga data 12.04.2023 deri me datë 26.04.2023, e ka shpallur duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Sipas konkursit me numër reference RN00011261, dhe njoftimit të datës 22.03.2023 i shpallur për aplikim nga data 12.04.2023 për grupin Specialist i Përgjithshëm i Psikologjisë për pozitën "Zyrtar për Çështje Psikologjike", në Komunën e Vushtrisë, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si:

- **Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve (180/ECTS).**
- **Kualifikime të Posaçme formale: Baçelor i Psikologjisë me të paktën 180/ECTS.**
- **Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 një vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.**

Fillimisht me datë 04.05.2023 me numër protokoli 19260/23 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vushtrisë ka nxjerr Njoftimin për verifikimin paraprak për grupin Specialist i Psikologjisë për pozitën "Zyrtar për Çështje Psikologjike" ku pas verifikimit paraprak kriteret e përgjithshme dhe të veçanta i ka plotësuar vetëm kandidatja ku gjithsej kanë aplikuar shtatë (7) kandidatë, ndërsa gjashtë (6) janë refuzuar. Në Njoftimin për verifikimin paraprak të datës 04.05.2023 kandidatët kanë pas udhëzim për mjetet juridike ku kandidatët e refuzuar kanë të drejtë që në afat prej 3 ditësh nga dita e njoftimit individual të ushtrojnë ankesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore.

Brenda afatit ligjor, Ankuesja _____ e datë 05.05.2023 ka parashtruar ankesë ndaj vendimit nr.19242/23 të datës 04.05.2023 për mos përfshirje në listë të ngushtë për shkak të mos dëshmimit të përvojës së punës me pasqyrën e trustit pensional, tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vushtrisë. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vushtrisë ka nxjerr Vendim me numër protokoli 19720/23 të datës 08.05.203 me të cilin ka aprovuar si të bazuar ankesën e parashtruar nga Edona Shotani. _____ ka parashtruar ankesë ndaj vendimit nr.19244/23 të datës 04.05.2023 për mos përfshirje në listë të ngushtë për shkak të mos dëshmimit të përvojës së punës me pasqyrën e trustit pensional, tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vushtrisë. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vushtrisë ka nxjerr Vendim me numër protokoli 19719/23 të datës 08.05.203 me të cilin ka aprovuar si të bazuar ankesën e parashtruar nga _____ dhe _____ ne datë 05.05.2023 ka parashtruar ankesë tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vushtrisë për mos përfshirje në listë të ngushtë për shkak të mos dëshmimit të përvojës së punës me pasqyrën e trustit pensional. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vushtrisë ka nxjerr Vendim me numër protokoli 19722/23 të datës 08.05.203 me të cilin ka aprovuar si të bazuar ankesën e parashtruar nga Zahide Tupella Ferati.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vushtrrisë me rastin e nxjerrjes së Njoftimit për verifikimin përfundimtar me numër 19747/23 të datës 08.05.2023 ka vepruar në pajtim me Rregulloren (QRK) NR.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës konkretisht nenin 15 paragrafin 6 ku përcaktohet se: *6. Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se në këtë procedurë testi me shkrim është mbajtur dy herë për shkak të problemeve ndërsa në testin e dytë nuk jemi nënshkruar me arsyetimin se na than që lista e parë mbetet e njëjtë me të dytën, Kolegji i Këshillit, konstaton se fillimisht testi me shkrim është caktuar të mbahet më datë 16.05.2023 dhe në të janë paraqitur katër kandidatë, mirëpo gjatë kësaj faze njërit prej kandidatëve u janë paraqitur probleme në kompjuter kjo dëshmohet edhe sipas emailit të datës 16.05.2023 të dërguar për Zyrtarët e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, duke e bashkangjitur edhe problemin që është shkaktuar, ku sipas kësaj kandidates që i'u janë shfuar problemet në testim nuk kam mundur t'i vazhdohet minutazhi prej 15 minutash dhe pasi që kjo nuk ka qenë e mundur atëherë edhe sistemi për të përfunduar procesin me shkrim nuk kishte qasje kjo është arsyetuar edhe nga ana e Komunës së Vushtrrisë respektivisht Njesisë së Burimeve Njerëzore. Pas kësaj kandidatët më datë 19.05.2023 janë njoftuar që ritestimi do të mbahet më datë 23.05.2023 nga ora 15:00, dhe për rrjedhojë më këtë datë në ritestim janë paraqitur të gjithë kandidatët e ftuar dhe të cilët sipas dëshmisë janë nënshkruar tek formulari i listës së aplikantëve pasi që të njëjtin janë nënshkruar edhe më datë 16.05.2023. Marr për bazë konstatimin si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqë testi me shkrim i datës 16.05.2023 nuk ka qenë i mundur të përfundohet si proces, atëherë mbajtja e testit me shkrim për herë të dytën konkretisht më datë 23.05.2023 për të gjithë kandidatët nuk është cenim i parimit të meritës dhe i procesit të pranimit, ngase kjo procedurë ka qenë për të gjithë kandidatët njëjtë dhe nuk ka pasur dallime në këtë çështje, kështu që pretendimet e ankueses janë të pabazuara ngase, janë respektuar parimet e përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, të përcaktuara me nenin 6 dhe parimet e përcaktuara me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konkretisht të përcaktuara me nenin 6.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar shtatë (7) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përzgjedhur katër (4) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja e cila e ka kaluar fazën e verifikimit dhe ka marrë pjesë në të gjitha fazat e rekrutimit, bazuar në renditjen përfundimtare të kandidatëve ankuesja ka marrë 52 pikë me shkrim, 20 pikë në jetëshkrim dhe 4.8 pikë në intervistë, e njëjta është vlerësuar me gjithsejtë shtatëdhjetë e gjashtë pikë tetë (76.8) pikë dhe është renditur e dyta në listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve.

Sipas Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe rrjedhimisht duke u bazuar në Shtojcën Nr.2 të kësaj Rregullore, për pozitën e punës "Specialist të Psikologjisë", e renditur në numrin rendor 54 është përcaktuar që për këtë grup tek fusha e kërkuar e arsimit kërkohet Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, bazuar në këtë ankuesja në bazë dëshmive të përgatitjes profesionale plotëson kushtet formale të konkursit po ashtu edhe kandidatja e renditur e para i plotëson kushtet formale të konkursit. Ndërsa lidhur me pretendimin e ankueses se a i plotësojnë kushtet lidhur me përvojën e punës tri 3

kandidatet tjera, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se kandidatët e përfshirë në listën e ngushtë i kanë plotësuar kriteret sipas konkursit të shpallur nga Komuna e Vushtrisë për pozitën "Zyrtar për Çështje Psikologjike" dhe se pretendimi i ankueses mbi faktet e lartcekura është i pabazuar.

Kolegji ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur posedon: Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Bachelor i Psikologjisë numër Nr.3097 të datës 06.02.2014, Diplomë nga Kolegji AAB i E.SH. me numër Nr.3766/22 i datës 21.10.2022; Certifikatë nga MASHTI për E.SH. me numër Nr.14814/008 e muajit shtator 2021; Certifikatë licencimi për E.SH. me numër Nr. i Licences 688/21 i datës 18.03.2021; Vërtetim nga Njësia e Personelit në Komunën e Vushtrisë për E.SH. me numër protokollit 42632/20 i datës 24.09.2020; Letër rekomandim nga Njësia e Personelit në Komunën e Vushtrisë për E.SH. me numër protokollit 11677/21 i datës 16.03.2021; Kontratë pune për punë dhe detyra specifike nga Komuna e Vushtrisë për E.SH. me numër protokollit 1065/21 i datës 31.08.2021; Certifikatë nga MASHTI për E.SH. me numër Nr.0065/18 e vitit 2018; Certifikatë nga për E.SH. i datës 21.11.2017; Rekomandim nga Drejtoresha e shkolles fillore "Mustafë Venhari" Vushtri për E.SH.; Certifikatë nga The cambridge school për E.SH. i datës 19.03.2014; Certifikatë nga The cambridge school për E.SH. i datës 29.07.2013; Certifikatë nga The cambridge school për E.SH. i datës 14.06.2013; Certifikatë nga qendra rinore Hareja për E.H. i datës 20.10.2004; Certifikatë nga The cambridge school për E.SH. i datës 30.07.2014; Pëlqim nga Drejtoria për Arsim në komunën e Vushtrisë i datës 19.01.2018; Letërnjoftim i E.SH.; Certifikatë mbi dënimet penale e E.SH. i datës 12.04.2023; Pasqyra e llogarisë nga trusti e E.SH. i datës 01.08.2002-02.05.2023; Vërtetim nga shpk. Te duli furniture për E.SH.; Kontratë pune për kohë të caktuar/të pacaktuar nga kopsht. për E.SH. i datës 01.06.2014; Kontratë pune për kohë të caktuar/ të pacaktuar nga D.P.Z. Te duli për E.SH. i datës 01.03.2019; Kontratë pune për punë dhe detyra specifike nga komuna e Vushtrisë për E.SH. me numër protokollit 1065/21 i datës 31.08.2021;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se Komisioni i Pranimit ka bërë vlerësimin e ankueses dhe kandidatëve të tjerë sipas procedurave sepse vlerësimi i kandidatëve përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë, siç parashihet me nenin 16 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa nga të gjitha vlerësimet e ndërlidhura me nenin 21, 22, 23 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me nenin 24 të kësaj rregulloreje, përcaktohet se: **"Shuma e pikëve të përfituara nga se cili kandidat në se cilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit "**. Bazuar në këtë publikim i renditjes përfundimtare të kandidatëve është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: **"2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues"**, mirëpo meqë në këtë konkurs është kërkuar vetëm një vend pune, atëherë kandidatja e renditur me më së shumti pikë që në bazë të listës së renditjes përfundimtare të kandidatëve është Edona Shotani që ka marr gjithsejtë tetëdhjetë e nëntë pikë tetë pikë 89.8 pikë, emërohet në këtë pozitë sipas nenit 26 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: **"Kandidati fitues, sipas renditjes, duke filluar nga ai me më shumë pikë, njoftohet nga njësia përgjegjëse për pozitën e lira dhe ka të drejtën të përzgjedhë çdo pozitë të lirë të Grupit dhe të emërohet në të, për të cilin është zhvilluar procedura e pranimit, si dhe në çdo pozitë tjetër të lirë të të njëjtit Grup, që krijohet e lirë deri në një (1) vit nga shpallja publike e listës të kandidatëve fitues"**.

Në bazë të të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankueses, konstaton se procedura për grupin 'Specialist të Psikologjisë' për pozitën 'Zyrtar për çështje psikologjike' në Komunën e Vushtrrisë, me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit deri tek përzgjedhja përfundimtare e kandidatës ka vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, 2 ligji nr. 06/l – 114 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se; 1. *Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve.* 2. *Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive, si dhe në pajtim me nenin 4, paragrafi 1 të Rregullores (QRK) nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet 1. *Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë.**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.884/2023.

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vushtrrisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

